



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA LEZHË

KRYETARI

PROJEKTVENDIM

Nr. 12268 datë 1.7.2022

“PËR

**MIRATIMIN E LISTES SË SUBJEKTEVE PËRFITUESE PËR GRANTE
RINDËRTIMI PËR BANESA NË NDËRTESA (PALLATE) ME SHKALLË DËMTIMI
DS4 DHE DS5 SIPAS ANALIZAVE TË THELLUARA TË INSTITUTIT TË
NDËRTIMIT NË BASHKINË LEZHË DHE STRUKTURES SË BANIMIT
PËRKATËSE”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit i Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.282, datë 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, VKB nr.79, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vertetimit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative, si dhe dokumentacionit tjetër plotësues, që vertetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vertetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e rindërtimit”, VKB nr. 22, datë 14.02.2020 “Për miratimin e manualit për procedurat e përfitimit

nga programet e procesit të rindertimit për strehim”, Kryetari i Bashkisë i paraqet Këshillit të Bashkisë Lezhë,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e listes së subjekteve perfituese për grante rindertimi për banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë dhe struktures së banimit përkatëse, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI
Pjerin Ndreu



Aneksi nr. 1

Bashkia Lezhe

Lagjja Beselidhja

SUBJEKTET QË PËFITOJNË DHE STRUKTURAT PËRKATËSE TË BANIMI

Nr.	Emer Atësi Mbiemer	Numri I Identitetit	Struktura e banimit që përfiton
1	Arben Gjon Doda	H20111058F	1+1
2	Ndue Geg Gazulli	H00731040E	1+1

KRYETARI

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 2269/ Prot.

Lezhë, më 1.7.2022

Lënda: Për projektvendimin “ Miratimin e listes së subjekteve perfituese për grante rindertimi për banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit të Bashkinë Lezhë dhe struktures së banimit përkatëse”.

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

KËTU

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit i Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durres, Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësite e tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.282, datë 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, VKB nr.79, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vertetimit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative, si dhe dokumentacionit tjetër plotësues, që vertetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vertetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e rindërtimit”, VKB nr. 22, datë 14.02.2020 “Për miratimin e manualit për procedurat e përfitimit

nga programet e procesit të rindertimit për strehim”, listes se perfituesve, bashkelidhur, paraqitet ky relacion ne Keshillin Bashkiak Lezhë.

Duke u mbështetur në nenin 101, të Kushtetutës, ku parashikohet se Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme, në ditët në vijim u miratua Akti normativ nr. 9, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, subjektët Arben Gjon Doda dhe Ndue Geg Gazulli me shkresat nr.13964 prot., datë 26.07.2021, nr.15094 prot., datë 19.08.2021 i janë drejtuar Bashkisë Lezhë me kërkesë për përfitim nga grantet e rindertimit pasi këto dy subjekte nuk kanë pasur mundësi të aplikojnë në sistem gjatë afatit të aplikimit për shkak se nuk ndodheshin në Shqipëri.

Subjektët e sipërcituara sipas dokumentacionit dhe verifikimeve të kryera pranë ASHK-së, Drejtoria Vendore Lezhë, rezulton që kanë pasur banesa në pallatin nr.3, rruga Lisus, Lagjja Besëlidhja, pallat i cili është prishur me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.69, datë 22.05.2020.

Drejtoria e Emergjencave Civile në Bashkinë Lezhë ka marrë në shqyrtim kërkesat e tyre dhe duke mbajtur në konsideratë:

1. Parashikimet e nenit 209 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë ku përcakton se: *“Në katet ose njësitë e ndara të kateve të një ndërtese që ndodhen në pronësi të veçantë të pronarëve të ndryshëm, janë në bashkëpronësi të detyrueshme të tyre, gjersa në aktin e pronësisë nuk është caktuar ndryshe, këto objekte:*

a) trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose tarraca, oxhaqet, si edhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët;

b) pusët, instalimet e ujit, instalimet elektrike, të gazit, të telefonisë e të ngrohjes qendrore, duke përfshirë edhe tubacionet dhe linjat përkatëse, si dhe kanalet e ndryshme deri në pikën e degëzimit të tyre brenda njërive të ndara të kateve.

2. Faktin që pallatet e reja në Lagjen Besëlidhja janë ndërtuar në të njëjtin truall ku subjektët kanë pasur banesat e tyre dhe kanë qënë bashkëpronar në pallatin e shembur për shkak të termetit:

Ka shpallur përfitues për grante e rindertimit dhe ka përcaktuar strukturën e banimit që përfitojnë banesë në pallatet e rindertuara në Lagjen “Besëlidhja”, si më poshtë:

Nr.	Emër Atësi Mbiemer	Struktura e banimit që përfiton
1	Arben Gjon Doda	1+1
1	Ndue Geg Gazulli	1+1

Struktura e banimit që përfitojnë subjektët e mësipërme nuk është në bazë të numrit të anëtareve të familjes por në bazë të sipërfaqës që ato kanë pasur në objektin e shembur nga termeti. Këto

subjekte përfitojnë në bazë të nenit 209 të Kodit Civil dhe nenit 21/2 të Aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si bashkëpronar të truallit ku do të rindertohen objektet e reja pasi në rastin e pllateve të Lagjes “Besëlidhja”, objektet e reja janë rindertuar në të njëjtin truall

Për arsyet e sipërcituara i jemi drejtuar Këshillit të Bashksië Lezhë me këtë projektvendim për të miratuar shpalljen përfitues dhe për të përcaktuar strukturën e banimit që subjektët e përcaktuar në këtë projektvendim.

KRYETARI

Pjerin Ndreu

